



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini dhe Sport
Mbledhja nr. 44
Prishtinë, më 20.04. 2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, Drita Kadriu, Heset Cakolli, Mark Krasniqi
Enis Kervan Donika Kadaj –Bujupi dhe Dragan Dimiq
Munguan :Memli Krasniqi.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i KDI-së, NDI - së, përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.03.2010
3. Diskutim rreth strategjisë së punës së Komisionit.
4. Diskutim i Komisionit lidhur me vizitat në Institucione.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi- konstatoi se rendi i ditës miratohet me ndryshimin të pikës së katërt në vend të fjalës ‘diskutim’ të zëvendësohet me fjalën ‘Informim’ .

Arsim Rexhepi –kryetar, i njoftoi anëtarët e Komisionit që në seancën e fundit, Kuvendi e ka emëruar kryetar të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport dhe urojë që të kemi bashkëpunim të frytshëm gjatë këtij legjislacioni. Ai njehërit falënderoi znj, Drita Kadriu për udhëheqje dhe bashkëpunim korrekt të komisionit për muajt paraprak.

Drita Kadriu, e përgëzoi kryetarin për emërimin e tij në këtë Komision. Ajo tha se për arritjen e suksesshme për të gjitha aktivitetet dhe detyrave e saja ka qenë bashkëpunimi në nivel me anëtarët e komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.03.2010.

Kryesuesi konstatoi se procesverbali i mbledhjes së 24.03.2010, u miratua me plotësimin e fjalisë së Enis Kervan.

Enis Kervan -theksoi se në procesverbal mungon fjalia ‘tekstet shkollore në gjuhën turke nuk duhet të vijnë të përkthyer nga Turqia apo vendet tjera por duhet të botohen në Kosovë.

3. Diskutim rreth strategjisë së punës së Komisionit.

Arsim Rexhepi –kryetar, tha se në bazë të strategjisë së punës të Komisionit, rrjedhin disa aktivitete në fushën e sportit dhe të kulturës, duke pasur parasysh se në këto fusha nuk është bërë mjaft, për këtë çështje hapi debat.

Drita Kadriu, kërkoi nga kryesuesi sqarim lidhur me këtë pikë të rendit të punës dhe kërkoi nga kryesuesi që i njëjti të prezantohet me shkrim para komisionit.

Kryesuesi – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, i njoftoi anëtarët e Komisionit, se kjo pikë është caktuar me qëllim që Komisioni të fillojë nismën e vënies së kontakteve për bashkëpunim me komisionet homologe nga Turqia, Shqipëria, Gjermania, Franca, Zvira etj. Përfitimi nga këto komisione janë t’i shkëmbejmë përvojat e tyre në fushën e arsimit sportit dhe kulturës, andaj këto plane do ta begatojnë edhe më qartë strategjinë e punës së Komisionit. Më pas tha se këtë propozim plan do ta prezantoi me shkrim në mbledhjen e ardhshme.

Heset Cakolli – uroi detyrën e kryetarit duke i dëshiruar bashkëpunim sa më të mirë. Në vijim tha se komisioni e ka miratuar planin e punës, ndërsa i mirëpret specifikimet e çështjeve të cekura nga kryetari.

Mark Krasniqi –përgëzoi kryetarin për detyrën e marrë. Ai u pajtua për pikat e propozuara nga kryetari dhe theksoi se puna kolegjiale do ti përafroi sfidat me të cilat ballafaqohet komisioni.

4. Diskutim i Komisionit lidhur me vizitat në Institucione.

Kryesuesi – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha anëtares, Drita Kadriu.

Drita Kadriu – tha se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, muajve të fundit ka zhvilluar një varg vizitash të frytshme, që kishin për qëllim

njohjen me punën, por edhe me sfidat që shtrohen para institucioneve nga lëmi i arsimit, kulturës, shkencës, teknologjisë, rinisë dhe sportit.

Në këtë vështrim vizita mjaft të frytshme u zhvilluan në Ministrinë e Kulturës, në Teatrin Kombëtar, në Institutin e Historisë dhe në Universitetin në themelim të Prizrenit .

Gjatë vizitës në MKRSK, nga Ministri i Kulturës- Valton Beqiri, e ka njoftuar Komisionin lidhur me çështjen e operës, problemet në sport, trashëgimin kulturore, për statusin e rëndë material të artistëve. Ligji për Teatrin nuk është duke u implementuar, ndërsa është në procedurë plotësimi dhe ndryshimi i tij.

Në Teatrin Kombëtar, nga drejtoresha Burbuqe Berisha, kemi marr një pasqyrë për gjendjen aktuale e sidomos me atë se Ligji për Teatrin nuk është duke u zbatuar dhe se draftimi i Ligjit është shumë i nevojshëm.

Drita Kadriu tha se, ka kërkuar nga përfaqësuesit e Teatrit Kombëtar të paraqesin gatishmëri për bashkëpunim me MKRSK-në, në përpunimin e të këtij Projektligji i cili do të rregullojë shumë çështje në këtë sferë.

Në fjalinë e saj tha, se Këshilli Kombëtar i Shkencës ka ofruar opinionet e tyre, se Instituti nuk ka zyrat e saja, nuk ka administratë dhe se këto janë arsyt e shumta që vështirësojnë funksionalizimin e tij.

Sa i përket Institutit të Historisë, janë në bisedime me MASHT-in për zgjedhjen e çështjes së objektit. Më pas tha, se sa i përket çështjes së pagave në këtë Institut ka diskriminim sepse administrata e thirrur me tituj shkencorë paguhet si nëpunës civil.

Në objektin e Universitetit të Prizrenit Komisioni u njoftua për aspektin teknik dhe organizativ për organizimin dhe funksionimin e këtij Universiteti.

Heset Cakolli - ai mendon, se lidhur me këto vizita janë marrë informata për punën dhe sfidat e Institucioneve nga lëmi i arsimit dhe kulturës. Njëkohësisht këto vizita reflektojnë pozitivisht edhe në angazhimet e Komisionit me rastin e drafatimit të projektligjeve përkatëse, si p.sh Ligji për Teatrin.

Në fjalinë e tij tha, se anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës kanë prezantuar programin kombëtar të shkencës për vitin 2015, i cili do të miratohet në Kuvend dhe njoftoi për sfidat me të cilat ballafaqohet ky Institut .

Më pas theksoi se, Universiteti i Prizrenit do të projektohet dhe adaptohet në objektet e shkollës së mesme ekonomike dhe të Fakultetit të Edukimit.

Sa i përket konkursit, komisioni është informuar nga sekretari lidhur me përzgjedhjen e stafit teknik dhe Akademik. Në fund theksoi se hapja e këtij Universiteti do të jetë model për regjion.

Mark Krasniqi-tha se, komisioni gjatë vizitave ka bërë hapa të rëndësishëm në mbikëqyrjen e Institucioneve. Ai tha se Instituti i Historisë nuk ka objekt të mjaftueshëm për zhvillimin e veprimtarive të saja dhe propozoi që sa më parë të bëhet zgjidhja e objektit të Institutit.

Donika Kadaj –Bujupi- theksoi se ende nuk është e definuar çështja e objektit të Institutit të Historisë. Ajo propozoi që në mbledhje të radhës të caktohet si pikë e veçantë: rishqyrtimi i Rekomandimit të vitit 2009, çka ka ndodh në teori, çka është ndërmarr lidhur me këtë çështje, pra të kemi njohuri se ku ka mbet zbatimi i tij.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport pas diskutimit lidhur me vizitën në Institutin e Historisë, nxori këtë:

Përfundim

Duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të këtij Instituti kërkon nga MASHT të dhëna plotësuese lidhur me çështjen e institutit të Historisë sa i përket godinës së këtij Instituti. Komisioni kërkon që të dhënat lidhur me marrëveshjen reciproke të MASHT-it me Institutin e Historisë rreth godinës së Institutit të dërgohen me shkrim para Komisionit ose në mënyrë elektronike në stafin mbështetës të Komisionit.

Drita Kadriu - kërkoj që komisioni të bëjë vizitë në Agjensionin për Akreditim e Licencim dhe me këtë propozim njëzëri u pajtua komisioni.

Komisioni vendosi që ditën e hënë me datën 26.04.2010 në ora 11:00 të vizitoi Agjensionin për Akreditim dhe Licencim.

5. Të ndryshme

Komisioni shqyrtoi edhe çështjen e ndërtimit të një objekti në afërsi të Urës së Gurit në Vushtrri.

Komisioni konsideron se pjesa përreth Urës së Gurit në Vushtrri është në mbrojtje të trashëgimisë kulturore të Kosovës, dhe kërkon informatë rreth këtyre ndërtimeve nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë z. Bajram Mulaku dhe nga Drejtoria kompetente rreth ligjshmërisë së ndërtimit në këtë zonë.

Kryesuesi – konstatoi që Komisioni do të mbajë mbledhje më datën 27.04.2010, në ora 11:00 në sallën N-225 dhe si pikë te veçantë do të ftojë Ministri e MASHT-it Enver Hoxhaj, që të marrim informatë rreth punës së Institucioneve arsimore të pa licencuara në Kosovë;

Të njëjtën ditë në orën 11,30, të ftohet rektori ku do të diskutoi çështjet aktuale në Rektoratin e Prishtinës.

Drita Kadriu – lidhur me pikën në të ndryshme, theksoi se në emër të komisionit ka marrë dokumentin nga Ambasada Turke që me datën 9-12 qershor 2010, të vizitojë Parlamentin e Turqisë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12: 30

Përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arsim Rexhepi